

QERSHOR 2026

BULETINI




Konferencë mbi sfidat e sistemit gjyqësor në veri të Kosovës

Përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, avokatisë, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile u mbledhën më 29 qershor në Prishtinë në një konferencë kushtuar funksionimit të sistemit gjyqësor në veri të Kosovës.

Pjesëmarrësit diskutuan për përfaqësimin institucional, qasjen në drejtësi, të drejtat gjuhësore, pozitën e komuniteteve joshumicë dhe mundësitë për rikthimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ nga komuniteti serb në sistemin e drejtësisë.

Konferenca u organizua me mbështetjen e UNMIK-ut dhe paraqet pjesën e parë të një dialogu më të gjerë, i cili do të vazhdojë në Mitrovicën e Veriut gjatë muajit korrik.





Takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile për Programin e të Drejtave të Njeriut

Më 10 qershor në Prishtinë u mbajt një takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile në kuadër të hartimit të Programit për Mbrojtjen dhe Avancimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore 2026–2031 dhe Planit të Veprimit 2026–2028.

Takimi u organizua nga ACDC në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, me qëllim që organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë në përmirësimin e këtyre dokumenteve strategjike përmes propozimeve dhe rekomandimeve të tyre.



Punëtori për përgatitjen për Provimin e Jurisprudencës në Kosovë

Më 23 qershor, ACDC organizoi një punëtori profesionale për juristë të rinj dhe studentë të drejtësisë që planifikojnë të japin Provimin e Jurisprudencës në Kosovë. Sesioni u mbajt nga gjyqtarja e Gjykatës Supreme, Milena Đerić, e cila prezantoi procedurën e provimit, strukturën e tij, literaturën e rekomanduar dhe këshilla praktike për përgatitje të suksesshme.

Aktiviteti u realizua me mbështetjen e UNMIK-ut.



Climate Walk frymëzoi të rinjtë për aktivizëm klimatik

Më 17 qershor, të rinjtë nga Mitrovica e Veriut morën pjesë në aktivitetin Climate Walk & Inspection, ku së bashku me ekspertë të mjedisit identifikuan sfidat kryesore mjedisore në komunitetin e tyre. Gjatë ecjes u evidentuan probleme si menaxhimi jo i duhur i mbeturinave, ndotja dhe mungesa e hapësirave të gjelbra. Gjetjet do të shërbejnë si bazë për rekomandime të cilat do të hartohen dhe promovohen nga vetë të rinjtë.

Aktiviteti u realizua në kuadër të projektit Climate Street Art Action – Walls that Speak for the Planet, si pjesë e Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë.



U krijua “Këndi i Gjelbër” në Rezidencën Artistike të Mitrovicës

Më 24 qershor, në oborrin e Rezidencës Artistike të Mitrovicës u krijua një Kënd i Gjelbër në kuadër të projektit Green Neighbors. Të rinjtë mbollën bimë dekorative dhe vendosën panele edukative me mesazhe mjedisore të hartuara prej tyre, duke kontribuar në krijimin e një hapësire më të gjelbër dhe më të këndshme për komunitetin. Projekti zbatohet nga organizata Education Code në partneritet me ACDC.



Dita Botërore e Mjedisit u shënua me një aksion pastrimi

Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, më 5 qershor ACDC organizoi një aksion pastrimi në zonën këmbësore që lidh Mitrovicën e Veriut me Zveçanin. Së bashku me vullnetarët e rinj u larguan sasi të konsiderueshme mbeturinash nga hapësirat publike, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për një qasje më të përgjegjshme ndaj natyrës.

Aktiviteti u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit që zbatohet nga CARE Deutschland e.V.



Të rinjtë prezantuan vizionin e tyre për komunitetin përmes artit

Punëtorja "Qyteti im, shtëpia ime, rruga ime", e mbajtur më 11 qershor në Rezidencën Artistike të Mitrovicës, mbledhi të rinj të cilët, përmes një shëtitjeje të përbashkët dhe punës artistike, prezantuan vizionin dhe idetë e tyre për përmirësimin e komunitetit lokal.

Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Aquarius, në kuadër të projektit që ACDC zbaton me mbështetjen e ATRC-së.

Iniciativa rinore për mbrojtjen e lumenjve në veri të Kosovës



Gjatë javës së fundit të qershorit u realizuan një sërë iniciativash rinore në kuadër të projektit Së Bashku për Lumenj të Pastër, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit.

Në Leposaviq u organizua një punëtori kreative-edukative që përfshiu pikturim në natyrë dhe shfaqjen e një filmi edukativ mbi mbrojtjen e lumenjve. Në Liqenin e Gazivodës, të rinjtë morën pjesë në një ligjëratë mbi speciet e rrezikuara, ndoqën një film edukativ dhe zhvilluan një aksion për pastrimin e bregut.

Muaji u përmbyll me ekspozitën fotografike Our Reflection në Shtëpinë e BE-së në Mitrovicën e Veriut, ku u prezantuan fotografi të realizuara nga të rinjtë që dokumentojnë ndotjen e lumenjve dhe theksojnë nevojën për mbrojtjen e tyre.





Vizitë në ambientet e rinovuara të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut

Gjatë vizitës së tij zyrtare në Kosovë, Nënsekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për Operacionet Paqeruajtëse, Jean-Pierre Lacroix, vizitoi ndërtesën e rinovuar të gjykatës dhe ambientet e Departamentit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut. Rinovimi u realizua në kuadër të një projekti të zbatuar nga ACDC me mbështetjen e UNMIK-ut, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës së institucioneve të drejtësisë dhe forcimin e qasjes në drejtësi.



Vizita e përfaqësuesve të Agjencisë Franceze për Zhvillim

Përfaqësuesit e Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD), Philippe Walfard dhe Vanina Pomonti, vizituan ACDC-në për të diskutuar rezultatet e projektit BOOST – Green Neighbors: Youth for Environment and Coexistence, i cili zbatohet në partneritet me organizatën Education Code.

Gjatë takimit u shqyrtuan edhe mundësitë për bashkëpunim të ardhshëm dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta.



ACDC ndër organizatat e mbështetura përmes programit rajonal LGBTQI+

Përfaqësuesit e ACDC-së morën pjesë në Podgoricë në ceremoninë e nënshkrimit të kontratave me organizatat e përzgjedhura në thirrjen e dytë të programit rajonal Së Bashku për Barazinë LGBTQI+.

Programi bashkon organizata nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe mbështet iniciativë që synojnë avancimin e të drejtave, dukshmërisë dhe përfshirjes së komunitetit LGBTQI+, me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian.

Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së foli në Bruksel për sfidat e sektorit mediatik në Kosovë

Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, mori pjesë në takim të Grupit Punues për Kosovën të Komitetit Evropian të Rajoneve, të mbajtur në Bruksel.

Gjatë panelit ai foli për sfidat kryesore me të cilat përballlet sektori mediatik në Kosovë, duke përfshirë qëndrueshmërinë e mediave të pavarura, përhapjen e dezinformimit, presionet politike dhe rëndësinë e ruajtjes së hapësirës demokratike dhe lirisë së shprehjes.





ACDC në media



- Gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 7 qershor, Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, dha intervista për disa media, përfshirë Kosovo Online, KoSsev, Radio KIM dhe Radio Kontakt Plus. Si përfaqësues i rrjetit Democracy in Action, ai komentoi procesin zgjedhor, punën e vëzhguesve, parregullsitë e raportuara dhe vlerësimin e përgjithshëm të zgjedhjeve në veri të Kosovës.



- Gjatë muajit qershor, Drejtori i Programeve i ACDC-së, Aleksandar Rapajić, dha një intervistë për Kosovo Online lidhur me zhvillimet politike pas zgjedhjeve parlamentare.




 www.acdc-kosovo.org 

 office@acdc-kosovo.org 

 www.facebook.com/Ngoacdc 

 www.instagram.com/acdc.kosovo 

 www.x.com/ngo_acdc 